



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE " DRINO 2002 " SHPK

Ne baze te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 me cilesine e ortakut: **Nexhip MEVLANI** i biri i Skenderit i datlindjes 05.02.1964 lindur dhe banuese ne Gjirokaster Nr 26 me leternjoftimi UG.nr. 284969

NENI 1

Themelon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " CDRINO 2002 " SHPK, me ortak te vetem **Nexhip MEVLANI**

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Gjirokaster Lagja "Pllake " Nr. 66.

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise " DRINO 2002 " SHPK eshte mbi 10 vjet me te drejte riperteritje.

NENI 4

Kapitali themelor i shoqerise tregtare " DRINO 2002 " SHPK eshte 100.000 leke i investuar ne mase te plote prej Ortakut te Vetem.

NENI 5

Shoqeria " DRINO 2002 " sh.p.k. do te kete si objekt :

" Ofrim sherbime telekomunikacioni ne zonat urbane e rurale, internet, sherbime me vlere te shtuar, impiante dhe linja elektrike , radiotelefoni, citofoni dhe mirembajtjen e tyre, linja te TL, g-linja te TU e te mesem.

Tregtimin me shumice dhe pakice, import- eksport te artikujve elektronik, elektroshtepijak elektrik etj.

NENI 6

Administrator i shoqerise eshte **Nexhim MEVLANI**

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

NEXHIP MEVLANI

Nexhip Mevlani



STATUT I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" DRINO 2002 " sh.p.k.

Ne baze te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ", ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregtar e Formalitetet qe duhen plotesuar ne te " formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar " **DRINO 2002** " e ortakut te vetem themelues **Nexhip MEVLANI**

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 1

" DRINO 2002 " sh.p.k. me ortak te vetem z.Nexhip MEVLANI i datlindjes 05.02.1964, lindur dhe banuese ne Gjirokaster madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar me leternjoftimi UG.Nr. 284969

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " DRINO 2002 " sh.p.k., eshte ne Gjirokaster Lagja "Pllake " Nr.69. Ajo ka te drejte te cele filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe legjislacionin e vendeve ku ato do te hapen.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare " DRINO 2002 " sh.p.k., eshte mbi 10 vjet me drejte ripertesitje

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 4

Shoqeria " DRINO 2002 " sh.p.k do te kete si objekt :

" Ofrim sherbime telekomunikacioni ne zonat urbane e rurale, internet, sherbime me vlere te shtuar, impiante dhe linja elektrike , radiotelefoni, citofoni dhe mirembajtjen e tyre, linja te TL, g-linja te TU e te mesem.

Tregtimin me shumice dhe pakice, import-eksport te artikujve elektronik, elektroshtepijak elektrik etj.

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themelor i shoqerise tregtare " DRINO 2002 " sh.p.k. eshte 100.000 leke i investuar ne mase te plote prej Ortakut te Vetem.

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te ndryshohet vetem me vendim te Ortakut te saj te Vetem.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 7

Shoqeria tregtare " DRINO 2002 " sh.p.k. eshte prone e Ortakut te vetem te saj, i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete z. Nexhip MEVLANI

NENI 8

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise, Ortaku emerom e puneson administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre.

Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht Ortakut te vetem.

MARREDHENIET E PUNES

NENI 9

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 10

Perfaqesimi i shoqerise tregtare " DRINO 2002 " sh.p.k. i perket Ortakut te Vetem, e cila eshte dhe administratore e saj.

Na mungese te saj shoqeria administrohet nga perfaqsesi ligjor me prokure te autorizuar vetem per tagreve te caktuara ne prokure.

KONTROLI I BRENDSEHEM

NENI 11

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili eshte pergjegjes perpara kesaj shoqerie per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 12

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te vecante te Ortakut te Vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE - FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale. Pjesa qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

NENI 13

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 14

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfardo shkak. Ne rast mbyllje, Ortaku i Vetem vendos mbi menytrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Ne rastin e likuidimit, emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER. Mbase behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria rregjistrohet nga rregjistri tregtar i asaj gjykate.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 15

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga administratori i saj.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
NEXHIP MEVLANI

Nexhip Mevlani




REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 7059 Rep.
Nr. 332 Kol.



VERTETIM

Sot, me date 26 Shtator 2002 (dymije e dy), ne zyren e Noterise Tirane para meje noteres u paraqit personalisht z. Nexhip MEVLANI i biri i Skenderit i datlindjes 05.02.1964, lindur dhe banues ne Gjirokaster lagja " Pllake " Nr 69, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi UG.Nr. 284969, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se sa me siper eshte akti i themelimit dhe statuti i shoqerise, i hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire e te plote e nenshkruan rregullisht dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
SMENDIE SHAHU
22.05.02.144865
[Signature]